

Vendim nr. 263 datë 11.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 11.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 27 (E) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: EDMOND ASLLANI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 437 (61-2019-6065), datë 30.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 161, datë 16.09.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2024-1115, datë 11.06.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 33, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, si dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 21.08.2018, në vendin e quajtur “Aksionistët Levan”, në aksin rrugor Fier-Vlorë, ka ndodhur një aksident automobilistik, ku automjeti i drejtuar nga kërkuesi është

përplasur me automjetin e drejtuar nga shtetasi L.T. dhe, në vijim, ky i fundit është përplasur me automjetin e drejtuar nga shtetasi A.T. Si rrjedhojë e aksidentit kanë gjetur vdekjen shtetasja M.T., shtatzënë, dhe janë dëmtuar rëndë shtetaset L.T., e mitur, si dhe shtetas të tjerë, pasagjerë në automjetet e përfshira në aksident.

2. Bazuar në kallëzimin e policisë rrugore për ngjarjen, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin penal nr. 1150 të vitit 2018 në ngarkim të kërkuesit, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290, paragrafët 1 dhe 4, të Kodit Penal (KP) dhe, në përfundim të hetimeve, ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq. Në kushtet kur viktimja L.T. ka qenë e mitur, me vendim të ndërmjetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur dërgimin e çështjes për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila kishte seksion të veçantë për gjykimin e të miturve.

3. Në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkuesi ka kërkuar pushimin e çështjes, duke pretenduar, ndër të tjera, se organi i akuzës nuk kishte dhënë asnjë argument se cilat ishin shkeljet që kishte kryer. Sipas tij, shkak përcaktues i pasojës së aksidentit kishin qenë veprimet e automjetit të drejtuar nga A.T., i cili kishte qenë duke udhëtuar me shpejtësi në anën e kundërt të karrexhatës. Deklarimet e tij përputheshin plotësisht me faktin e ndodhur, ndërsa qëndrimet e dëshmitarëve në seancë kishin qenë të ndryshme nga dëshmitë e dhëna prej tyre në fazën e marrjes në pyetje nga organi i akuzës. Aktekspertimet provonin qartë se shkeljet e tij ishin vetëm administrative e jo penale, ndërkohë që kishte qenë pikërisht ai që i kishte dhënë ndihmën e parë viktimës.

4. Në përfundim të shqyrtimit të provave dhe vlerësimit të pretendimeve të parashtruara nga palët në gjykim, me vendimin nr. 437 (61-2019-6065), datë 30.10.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim për kryerjen e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290, paragrafi 1, i KP-së dhe me 6 vjet burgim për kryerjen e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290, paragrafi 4, i KP-së. Në bashkim të dënimeve, bazuar në nenin 55 të KP-së, kërkuesi është dënuar përfundimisht me 6 vjet burgim.

5. Kërkuesi ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi, duke pretenduar, ndër të tjera, se organi i akuzës e kishte deklaruar fajtor bazuar në aktin e ekspertimit të kryer nga inxhinieri D.V., ndërkohë që nuk kishte marrë parasysh aktin e ekspertimit të grupit të ekspertëve, sipas të cilit rezultonte se nga ana e tij kishte vetëm mospozicionim të rregullt në rrugë, çka klasifikohet si shkelje administrative që dënohet me gjobë. Sipas kërkuesit, ai vetëm sa ishte

fërkuar me automjetin e drejtuar nga shtetasi L.T. gjatë pozicionimit në rrugë për të krijuar fushëpamje parakalimi dhe aksidenti kishte ndodhur si rrjedhojë e devijimit të këtij të fundit, për shkak të ardhjes përballë të automjetit të drejtuar nga A.T., i cili parakalonte në mënyrë të gabuar. Ekspertët kishin konkluduar se nëse rruga do të ishte bosh drejtuesi L.T. mund të kishte frenuar normalisht automjetin e tij. Po sipas kërkuesit, ngjarja kishte ndodhur si rrjedhojë e episodeve të ndara, ku episodi i parë nuk kishte pasur asnjë ndikim tek i dyti. Dëshmitë e dhëna në gjykim nga A.T. dhe L.T. kishin qenë të ndryshme nga ato të dhëna në fazën e marrjes në pyetje, shkak për të cilin gjykata kishte pranuar kërkesat e tij për kundërshtimin e tyre.

6. Me vendimin nr. 161, datë 16.09.2020, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke e vlerësuar atë të drejtë dhe të bazuar në ligj.

7. Kërkuesi ka ushtruar rekurs ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, duke parashtruar, në thelb, të njëjtat pretendime si ato në ankim. Me vendimin nr. 00-2024-1115, datë 11.06.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke i vlerësuar vendimet e gjykatave më të ulëta të drejta dhe të arsyetuara në përputhje me nenet 152 dhe 383 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

8. Në datën 02.10.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili pas plotësimit, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 11.10.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi, ndonëse e ka kryer dënimin e dhënë, ai është dënuar padrejtësisht nga gjykatat, duke u deklaruar fajtor për një veprë që nuk e ka kryer. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh aktin e ekspertimit me grup ekspertësh, i cili e përjashtonte atë nga kryerja e veprës penale dhe tregonte se vepra ishte kryer nga shtetasit L.T. dhe A.T., ndërkohë që kanë pranuar kundërshtimet e tij për deklaratat e dëshmitarëve të akuzës. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë ka pranuar se ka funksion rishikues edhe për gabimet në fakt, pra për bazueshmërinë në prova të vendimeve të gjykatës së rrethit dhe apelit, ndërkohë që nuk ka marrë parasysh pretendimet thelbësore të tij, me arsyetimin se nuk bën vlerësim të provave.

- 9.2. *Së drejtës për të marrë në pyetje dëshmitarët*, të garantuar nga neni 31, shkronja “d”, i Kushtetutës, pasi gjykatat nuk kanë marrë parasysh kërkesën e tij për thirrjen e dëshmitarit okular P.T., i cili do të hidhte dritë mbi ngjarjen. Ndonëse dëshmitarët e akuzës ishin në marrëdhënie të posaçme me njëri-tjetrin, qëndrimi i këtij dëshmitari nuk përputhej me atë të të tjerëve.
- 9.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk kanë arsyetuar për shkaqet e mosmarrjes parasysh të aktit të ekspertimit autoteknik të grupit të ekspertëve, ndërkohë që kishin detyrimin të argumentonin me hollësi shkaqet e mospranimit të përfundimit të nxjerrë prej tyre. Po kështu, ato nuk kanë arsyetuar për kërkesën e tij për thirrjen në gjykim të dëshmitarit P.T.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimin kushtetues.

11. Kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë

cenuar nga akti i pushtetit publik. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive kërkon që, përpara se t'i drejtohet Gjykatës, kërkuksi duhet të vërtetojë se ka përdorur në formë dhe substancë të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 38, datë 12.07.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, në ankimin kushtetues individual kërkuksi ka pretenduar cenimin e së drejtës për të marrë në pyetje dëshmitarët dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si rrjedhojë e mosmarrjes parasysh nga gjykatat të kërkesës së tij për pyetjen e dëshmitarit P.T. dhe mosarsyetimit në lidhje me të. Nga materialet e vëna në dispozicion të Gjykatës së bashku me ankimin kushtetues individual, Kolegji vëren se kërkuksi nuk e ka ngritur këtë pretendim në ankimin drejtuar gjykatës së apelit ose rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, duke mos shteruar në substancë mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës dhe, në këto kushte, nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

14. Për sa u përket pretendimeve të tjera për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si rrjedhojë e mosarsyetimit të gjykatave për shkaqet e mosmarrjes parasysh të aktit të ekspertimit të grupit të ekspertëve, të cilat i ka parashtruar në thelb në gjykatat e zakonshme, Kolegji vlerëson se kërkuksi nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

15. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se vendimi i fundit në kohë që ka përmbyllur procesin penal, është ai i Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 11.06.2024, ndërsa kërkuksi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 02.10.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, në ankimin kushtetues individual kërkuksi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të prezumimit të pafajësisë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues. Për sa i përket prezumimit të pafajësisë, Kolegji vëren se kërkuksi ka pretenduar cenimin e tij, si rrjedhojë e mosvlerësimit të provave nga Gjykata e Lartë.

17. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se neni 141 i Kushtetutës i ka dhënë Gjykatës së Lartë kompetencën e shqyrtimit të çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit. Respektimi

rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 12, datë 15.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se pretendimet e kërkuarit se Gjykata e Lartë ka pranuar juridiksionin e saj për shqyrtimin e provave në rastin e gabimeve gjyqësore, i përkasin procedurës së rishikimit, e cila nuk ka lidhje me çështjen në shqyrtim. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuarit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë për këtë shkak janë haptazi të pabazuara.

19. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuarit në lidhje me cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, duke pasur parasysh argumentet në thelb të tyre, Kolegji çmon t'i analizojë ato në vijim të lidhura së bashku.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

20. Kërkuari ka pretenduar se është dënuar gjykatat, duke u deklaruar fajtor për një vepër që nuk e ka kryer. Sipas tij, gjykatat nuk kanë marrë parasysh aktin e ekspertimit me grup ekspertësh, i cili e përjashtonte nga kryerja e veprës penale dhe tregonte se vepra ishte kryer nga shtetasit L.T. dhe A.T., ndërkohë që kanë pranuar kundërshtimet e tij për deklaratat e dëshmitarëve të akuzës. Po sipas kërkuarit, gjykatat nuk kanë arsyetuar për shkaqet e mosmarrjes parasysh të këtij akti ekspertimi, ndërkohë që kishin detyrimin të argumentonin me hollësi shkaqet e mospranimit të përfundimit të nxjerrë prej tyre.

21. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky parim kushtetues ka gjetur pasqyrim edhe në nenin 4 të KPP-së, i cili përcakton, gjithashtu, se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. Në jurisprudencën kushtetuese parimi i prezumimit të pafajësisë është elaboruar në drejtim të faktit se gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuzat. Gjykatat duhet të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që

deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Sipas këtij parimi asnjë dënim ose masë që barazohet me të nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 8, datë 20.02.2024; nr. 12, datë 24.08.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa i përket së drejtës për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, Gjykata ka theksuar se, si pjesë e së drejtës për proces të rregullt ligjor, ajo garantohet nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Sipas Gjykatës, arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 8, datë 20.02.2024; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 63, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në këndvështrim të këtyre standardeve kushtetuese, Kolegji çmon të analizojë në vijim pretendimet e parashtruara nga kërkuesi në ankimin kushtetues individual për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor përkundrejt vendimmarrjeve të gjykatave të zakonshme në këtë drejtim, për të përcaktuar nëse vendimet e këtyre të fundit janë analizuar në aspektin kushtetues, për sa i përket konkluzionit të arritur për kryerjen nga kërkuesi të veprës penale, si dhe nëse gjykatat kanë arsyetuar vendimmarrjet e tyre në këtë drejtim.

24. Në çështjen në shqyrtim, Kolegji vëren se nga materialet e depozituara nga kërkuesi së bashku me ankimin kushtetues individual rezulton se ai është akuzuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për kryerjen e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290, paragrafët 1 dhe 4, të KP-së. Në kuadër të këtij procedimi janë kryer një sërë veprimesh hetimore, si këqyrja e vendit të ngjarjes; pyetja e personave të përfshirë në aksident; ekzaminimi i kufomës; kryerja e ekspertimeve mjekoligjore ndaj shtetasve L.T., K.T., L.T. dhe pasagjerëve të tjerë të përfshirë në aksident, kryerja e ekspertimit autoteknik; kryerja e ekspertimit me grup ekspertësh; kryerja e testit *Gyp Drager*. Sipas provës së parë të këtij të fundit, ka rezultuar se kërkuesi kishte përdorur alkool në masën 0.08%, ndërsa sipas provës së dytë në masën 0.07%. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

25. Pas kalimit të çështjes për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për shkak se një ndër viktimat e veprës penale ishte e mitur, kjo e fundit ka vendosur deklarin e kërkuesit fajtor dhe dënimin e tij përfundimisht me 6 vjet burgim. Sipas gjykatës, arsyetimi i grupit të ekspertëve se automjeti i shtetasit A.T. mund të kishte qenë në korsinë e gabuar ishte i pabazuar në prova, pasi rezultonte e provuar se shkak i aksidentit kishte qenë pamundësia e drejtuesit L.T. për të kontrolluar automjetin pas goditjes së tij nga automjeti i drejtuar nga kërkuesi dhe reagimet e L.T. kishin qenë të ndikuara nga goditja e mëparshme e automjeteve (shih faqet 7-13 të vendimit nr. 437 (61-2019-6065), datë 30.10.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë). Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila ka vlerësuar se konkluzionet e ekspertëve nuk përputheshin me të dhënat për dinamikën e ngjarjes, dëshmitë e dëshmitarëve dhe provat e tjera, sipas të cilave rezultonte se, me dashje, kërkuesi kishte kryer manovër parakalimi, pa u siguruar më parë për trafikun dhe sinjalistikën (shih faqet 13-20 të vendimit nr. 161, datë 16.09.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë). Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se vendimmarrja e gjykatave ishte arsyetuar në përputhje me nenet 152 dhe 383 të KPP-së, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit, ndërsa gjykata apelit kishte argumentuar në mënyrë të detajuar se përse nuk kishte pranuar mendimin e ekspertëve, duke e çmuar këtë provë edhe me provat e tjera të marra gjatë shqyrtimit gjyqësor (shih faqet 13-15 të vendimit nr. 00-2024-115, datë 11.06.2024 të Gjykatës së Lartë).

26. Në analizë të vendimmarrjeve të mësipërme të gjykatave, Kolegji vëren se, në përputhje me parashikimet e nenit 152 të KPP-së, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesit për gjetjet e aktit të ekspertimit të grupit të ekspertëve, duke i analizuar ato përkundrejt tërësisë së provave të marra gjatë hetimit penal dhe shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Në përfundim të vlerësimit të tyre, gjykatat kanë arsyetuar qëndrimin e mbajtur për shkaqet e mospranimit të konkluzioneve të arritura në aktin e ekspertimit të grupit të ekspertëve për sa i përket fajësisë së kërkuesit, si rrjedhojë e mospajtit të tyre me provat e tjera. Vendimet e gjykatave më të ulëta janë mbështetur vetëm në faktet e paraqitura gjatë procesit gjyqësor dhe përmbajnë bazën ligjore, analizën e provave, përfshirë edhe analizën për aktin e ekspertimit, si dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes, konkretisht deklarin e kërkuesit fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar. Mënyra se si gjyqtarët e gjykatës së rrethit dhe të apelit kanë çmuar opinionin e ekspertëve është vlerësuar në vijim nga Gjykata e Lartë, e cila i ka vlerësuar vendimmarrjet e tyre në respektim të parimit të prezumimit të pafajësisë në drejtim të të provuarit të fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Në këtë këndvështrim, Kolegji çmon se vendimet gjyqësore rezultojnë të arsyetuara në aspektin kushtetues, në respektim të së drejtës së kërkuarit për t'u dëgjuar.

27. Për sa më sipër, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuarit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, janë haptazi të pabazuara.

28. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.